

Prezantohet projekti Kompetenca në Universitetin e Prishtinës

Studentëve do tu ofrohen programe studimi me karakter ndërkombëtar

PRISHTINË, 26 MAJ ■ Njëra ndër sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria e Kosovës është reformimi i arsimit të lartë, kështu është shprehur Rektori i Universitetit të Prishtinës Mujë Rugova të martën në prezantimin e projektit “Kompetenca në Universitetin e Prishtinës”, financuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS. Rugova, tha se ky projekt ka për qëllim themelimin e një qendre të kompetencës në UP, e cila do të kontribuojë në sigurimin e cilësisë dhe në zhvillimin e partneriteteve me ndërmarrjet lokale.

“Universiteti i Prishtinës si i vetmi institucion publik që ka një numër të madh të njëjësive akademike dhe studentëve në Kosovë, në vazhdimësi mbetet i përkushtuar që t’ju ofrojë studentëve studime cilësore të standardeve përrëndimore”, theksoi rektori Rugova. Ai tha se Universiteti i Prishtinës do të bashkëpunojë ngushtësisht me institucionet e arsimit të lartë të vendeve të ndryshme të Evropës, në mënyrë që studentëve t’iu ofrojë sa më shumë programe studimi që kanë karakter ndërkombëtarë. “Këtij qëllimi i shërben edhe ky projekt i TEMPUS-it, Kompetenca në Universitetin e Prishtinës i cili po fillon implementimin e tij tani”, tha Rugova. Naim Hasani, drejtor i Departamentit të Arsimit të Lartë në MASHT-së, theksoi se në kuadër të projektit do të zhvillohet një sistem i informacionit që do të bëjë arsimin më transparent dhe më të arritshëm. “Nga ky pro-



jekt do të përfitojnë të gjithë studentët dhe stafi i UP-së. Do të zhvillohet katalogu i kompetencës i bazuar në aktivitete projekteve të mëparshme si dhe në transferimin e njohurive në fund do të zhvillohet një sistem informativ i cili do të përmbledh të gjitha këto të dhëna dhe informacionet e projektit”, theksoi Hasani. Qendra e kompetencës do ta lidhë tregun e punës me arsimin e lartë përmes programit TEMPUS. ■ **A. Meha**

Marketing

REISEBÜRO PRISHTINA

Fluturoni me çmimet më të lira!

PRISHTINË - STAMBOLL
Bileta kthyesë për vetëm
199€

PRISHTINË - LONDËR
Bileta kthyesë për vetëm
260€

"BOTA SOT"
27/05/2011